



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni veror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 20.

Prishtinë, më 10.10.2011 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Mungoi:, Petar Miletic

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, përfaqësuesit nga KDI-Besnik Ramadani, përfaqësuesi i KKK-Veton Berisha, përfaqësuesi nga Presidenca-Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës.**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,**
3. **Të ndryshme**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - propozoi që rendi i ditës të plotësohet me pikën: kërkesa e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloret të Kuvendit të Kosovës.

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua me këtë plotësim.

5. **Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,**

Kryesuesi – Në fjalinë e tij tha se raporti me rekomandime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, nuk është miratua në Kuvend me arsye të vërejtjeve të paraqitura nga raport i Komisionit për Integritet Evropian.

Kryesuesi – theksoi se së për këtë takim komision ka ftuar përfaqësuesin nga Zyra e Kryeministrit- Zyra për Komunitete Srdjan Popovic, me qëllim të ofrimit të informatave të nevojshme, këshillime mendime dhe sugjerimeve lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe lidhur me sugjerimet e propozuara nga znj Myfera në amendamentin 3, në raportin me rekomandime të komisionit funksional.

Srdjan Popovic- falënderoi komisionin për ftesën e bërë dhe njëherit shprehu qëndrimin e tij se përfaqëson zyrën për komuniteteve, në kuadër të Qeverisë.

Ai theksoi se Projektligji sipas ndarjes formale, ka radhitje të mirë të neneve dhe se ka të bëjë me ndryshimin e ligjit aktual dhe plotësimin e dispozitave ekzistuese.

Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe përfaqësues të Qeverisë, Zyrës së Presidentit dhe agjencive tjera relevante.

Ai mbrojti qëndrimin e Qeverisë dhe shtoi se komisioni duhet ta miratojë projektligjin pa ndryshime dhe se i njëjti nuk është në lajthitje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ai mendon se propozim amendamenti i dhënë nga znj Myfera, fjala ‘mund të jenë’, të zëvendësohet me fjalën ‘, duhet të jenë’, nuk është shprehje adekuate sepse fjala ‘duhet’ është fjalë obliguese.

Kryesuesi – me theks të veçantë tha se për gjetje të një zgjidhje adekuate lidhur me projektligj, paraprakisht është mbajtur një takim pune me znj Mzfera Sinik, z, Elmi Reçica, ku është arritur një kompromis i përbashkët. Andaj sot komisioni do ta dal me propozim amendament , i cili do të jetë gjithëpërfshirës për të gjitha komunitetet dhe se i njëjti nuk do të jetë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë çështje fjalën ia dha znj Myfera Sinik

Myfera Sinik – tha se pas takimit është marr qëndrim të dalim me amendament final, andaj e njoftoi komisionin se ka kërkuar kohë shtesë, që komisioni ta ketë para vetës në formë të shkruar. Ajo dha një pasqyrë të shkurtër lidhur me propozim amendamentin :

Neni 3. Paragrafi 12.6, ka këtë përmbajtje:

Komuniteti Malazez dhe Kroat, në Këshillin Konsultativ, do të kenë nga 2 përfaqësues.

Komuniteti Rom, Egjiptas, Ashkali dhe Goran do të kenë nga dy përfaqësues, prej të cilëve një duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës.

Komuniteti Turk dhe Boshnjak i kanë nga tre përfaqësues prej të cilëve një duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës.

Komuniteti serb i ka pesë përfaqësues, prej të cilëve dy duhet të jenë deputetë të Kuvendit të Kosovës ”

Albert Kinolli - tha se në takimin e kaluar komisioni është akorduar njëzëri që të gjetjen e një zgjidhje afatgjate lidhur me këtë projektligj dhe se nuk do të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Për këto arsye kemi propozuar që në takim të jenë prezent përfaqësuesit nga zyra e Qeverisë, ti dëgjojmë opinionet e tyre pastaj komisioni të dal me qëndrim të vet.

Në diskutimin e tij tha se përkrah amendamentin e propozuar nga znj Myfera . Ai parashtrij pyetje se raporti me amendamente i propozuar nga Komisioni funksional, a do të ketë përkrahje nga komisionet e përhershme.

Më pas shtoi se komisioni duhet të jetë më transparent kur shqyrtohen çështjet e rëndësishme të veçantë që më pas të mos kemi lajthitje të njëjta si me këtë Projektligj.

Etem Arifi – pajtohet me parafolësin se komisioni ka gjetur kompromis në gjetjen e një zgjidhje të përhershme lidhur me hartimit e amendamentit në nenin 3, paragrafi 12. të Projektligjit. Nëse komisioni i vlerëson propozim amendamentet janë në përputhje me Ligjin dhe se nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, atëherë parashtrohet pyetja pse të njëjtat mund të kundërshtohen nga komisionet tjera.

Kryesuesi – theksoi se për një zgjidhjeje përfundimtare të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, janë vu kontakte edhe me përfaqësuesit e ICO-së dhe përfaqësuesit e Qeverisë. Në bazë të konsultimeve të përbashkëta është arritur kompromis i duhur, ku komisioni do të dal me Raport final, me qëllim që me këtë Projektligj të mbrohen të drejtat e komuniteteve dhe se i njëjti nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Agim Kuleta – theksoi se vet procedimi i Projektligjit, paraqet kontekst se nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës: Sipas tij, në këtë rast ligji i paraprin Kushtetutës. Nëse komisioni merr qëndrim të miratohet raportin me rekomandime atëherë mirë është që të respektohen procedurat parlamentare. Mendon se komisioni duhet të votoi propozim projektligjin të dërguar nga Qeveria dhe nën dy, propozimin e grupit parlamentar 6+.

Rasim Demir- e njoftoi komisionin se duhet të ketë parasysh faktin se amendamenti i propozuar nga znj Myfera është riformuluar nga grupi parlamentar 6 + . Ai konsideron se i njëjti duhet të inkorporohet në Raport me rekomandime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës..

Kryesuesi – në pyetjen pse janë prezent përfaqësuesit e KKK, me qëllimin më të mirë janë ftuar në takim që ti ndëgjojmë sugjerimet e tyre në lidhje me modifikimin e Projektligjit. Ai shtoi se grupi punës për Legjislacion në Këshillin Konsultativ për Komunitete ka paraqitur propozimet e tyre në formë të rekomandimeve . KKK nuk pajtohet me propozimin e amendamentit 3. për ta ndryshuar përmbajtjen e anëtarëve të Këshillit Konsultativ që parashihet në nenin 12,6. Propozimi i tyre është që komisioni funksional, të mos ndryshoj nenin 12,6 të Ligjit ekzistues.

Elmi Reçica –. Me theks të veçantë tha se komisioni realisht gjendet në një situatë të veçantë dhe se në bazë të përgjegjësisë të saja duhet të jetë unik në vendimmarrje. Propozimi nga grupi punues i KKK, nuk mund ta ndryshojë vendimmarrjen e komisionit tan.. Ai konsideron se komisioni duhet të bazohet në dy propozime konkrete, në vendimin e Qeveris dhe propozimin e grupit parlamentar 6 plus. Ndërsa, sa i përket miratimit të projektligjit për këtë çështje do të vendos Kuvendi.

Lumnije Morina – theksoi se komisioni në këtë çast ka marr rekomandimin nga KKK. Gjatë analizës së bërë, mendoj se me këtë rekomandim KKK propozon që të mos ndryshohet përbërja e Këshillit Konsultativ dhe se i njëjti nuk ka paraparë përfaqësimin e komunitetit malazez dhe atij kroat. Në fjalinë e saj tha se Qeveria ka hartuar Projektligjin për ndryshim dhe plotësim me qëllimin më të mirë për të definuar konkretisht përfaqësimin e komunitetit malazez dhe atij kroat, si komunitete të Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë paqartësi ajo kërkoi nga pjesëmarrësit e KKK që të ofrojnë sqarime konkrete.

Veton Berisha – tha se grupi ynë punues është pro përfaqësimit të komunitetit malazez dhe atij kroat sepse në Këshill pjesëmarrja e tyre do të ndihmojë në zhvillimet e proceseve aktuale. Ai konsideron se grupi punues i KKK, me rekomandim është drejtuar komisionit funksional, që të mos ndryshohet neni 12,6 i Ligjit ekzistues, nga se ky ligj nuk e pamundëson pjesëmarrjen e deputetëve të komuniteteve jo shumicë të Kuvendit të republikës së Kosovës në Këshillin

Konsultativ për Komunitete, për kjo çështje do të mbetet në vullnetin e organizatave përfaqësuese, të akredituara në zyrën e Presidentit.

Në bazë të diskutimeve të shumta dhe rezultateve të votimit, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

Përfundim

Me shumicë të votave Komisioni miratoi propozim amendamentin e grupit parlamentar 6 + si amendamente të Komisionit në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Të behët harmonizimi i tekstit të projektligjit, versioni në gjuhën serbe dhe angleze, me tekstin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 2

Neni 1. fshihet

Amendamenti 3

Neni 3. Paragrafi 12.6 riformulohet si vijon:

12.6 „Këshillin Konsultativ për Komunitete e përbëjnë pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të Qeverisë së Kosovës; të Zyrës së Presidentit dhe të institucioneve tjera të rëndësishme.

Komuniteti Malazez dhe Kroat, në Këshillin Konsultativ, do të kenë nga 2 (dy) përfaqësues.

Komuniteti Rom, Egjiptas, Ashkali dhe Goran do të kenë nga dy (2) përfaqësues, prej të cilëve një (1) duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës.

Komuniteti Turk dhe Boshnjak i kanë nga (3) tre përfaqësues prej të cilëve një (1) duhet të jetë deputet i Kuvendit të Kosovës.

Komuniteti serb i ka pesë (5) përfaqësues, prej të cilëve dy (2) duhet të jenë deputetë të Kuvendit të Kosovës ”

Për secilin anëtar, mund të emërohet një zëvendës anëtar. Ata anëtarë të cilët nuk janë deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë zakonisht kryesues apo zëvendës kryesues apo të emëruar të tjerë të lartë të organizatave përfaqësuese të komuniteteve apo përfaqësues të shoqatave ose OJQ-ve që kanë të bëjnë me komunitetin e caktuar.

Agim Kuleta – ai tha se apstenon lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Arsyetimin e dha se Projektligj duhet të jetë në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi - në lidhje me kërkesën e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloret të Kuvendit të Kosovës është në procedurë të hartim ndryshimit të Rregullores së Kuvendit. Ai tha se nënkomisioni ka udhëzuar komisionet parlamentare që në afat prej dy javësh të përshkruajnë fushëveprimtarit e tyre.

Gjithashtu edhe Komisioni janë duhet të ofroi propozimet në fushëveprimtarin e punës me pasyqrimin e të gjitha aktiviteteve

Pasi ky dokument është paraqit për her të parë në Komison, anëtarët e komisionit kërkuar afat shtesë në periudhe kohore prej një jave që ti shqyrtojnë më detalisht propozimet për ndryshim dhe plotësim të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe më pas të dalin me propozime konkrete.

Komisioni muar qëndrim se propozimet perfundimtare do të shqyrtohen dhe miratohen në komision dhe të njejtat do ti dërgohen nënkomisionit për shqyrtim të mëtejme.

Të ndryshme

Kryesuesi – tha se si pikë të ndryshme është propozimin nga OSB-ja që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të mban një takim punë dy ditore dhe temë diskutimi do të jetë, njoftim lidhur me rolin, arritjet dhe sfidat e komisionit, mekanizmat ekzistuese për mbrojtjen e të drejtave dhe interesat e komuniteteve dhe kthim.

Për viziitë është propozuara Prevala dhe qyteti i Gjakovës. Anëtarët propozuan që vizita të bëhet në Preval.

Ai shtoi, për informata detajuese komisioni do të njoftohet me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic